

Instituti për Studime të Avancuara GAP

Drenasi – Raporti komunal

Nëntor 2009

Drenasi në shifra

Popullsia	Gjithsej	68526
	Shqiptarë	100%
Gjeografia	Sipërfaqja (km ²)	290
	Numri i fshatrave	41
Shkollimi	Pa shkollë/fillore e papërfunduar	9.61%
	Fillore/e mesme e papërfunduar	41.48%
	E mesme	41.34%
	Shkollë e lartë	6.11%
	Universitet	1.46%
	Nr. i nxënësve	15,858
	Nr. i mësimdhënësve	791
	Nr. i shkollave të mesme (me paralele të ndara)	3
	Nr. i shkollave fillore (me paralele të ndara)	32
	Nr. i çerdheve	3
	Shëndetësia	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
Qendra të Mjekësisë Familjare dhe punkte shëndetësore		8
Nr. i mjekëve		38
Papunësia	Gjithsej	64.06%
	Meshkuj	61.01%
	Femra	73.55%
Të punësuar	Fuqi punëtore (15-64 vjet)	41,801
	Të punësuar në sektorin publik komunal	1,291
Buxheti 2009	Gjithsej (Euro)	6,500,280
	Të hyrat vetanake të planifikuara (Euro)	465,350
	Të hyrat tjera (Euro)	6,034,930
Shpenzimet e realizuara (2008) ¹	Gjithsej (Euro)	5,358,965 (91%)
	Shpenzimet kapitale (Euro)	875,488 (68%)
	Shpenzimet tjera (Euro)	4,483,477 (97.9%)
Rezultatet e zgjedhjeve lokale 2007	PDK	71.12%
	Iniciativa e Bashkuar Qytetare - IBQ	9.58%
	AAK	7.02%
	LDK	3.94%
	AKR	3.02%
	LDD	2.36%
	ORA	2.20%
	Tjera	0.76%
Kryetarët e Komunës 2000-2009	2000-2002: Izet Ibrahimimi (PDK) 2002-2007: (2002-2005) - Gani Sylaj (PDK) (2005-2007) - Sherif Krasniqi (PDK) 2007-2009: Nexhat Demaku (PDK)	

¹ Në kllapa ndodhen përqindjet e shpenzimit të buxhetit që ka qenë në dispozicion.

Shkurt për Drenasin

Edhe pse zyrtarisht kjo komunë ka emërtimin Glllogoc, shumë pak qytetarë e përdorin këtë emërtim. Në gjuhën e folur dhe në shumë shkresa emërtimi më i zakonshëm është Drenas. Drenasi bën pjesë në rajonin e Drenicës dhe është një nga komunat e cila së bashku me Skenderajin kanë qenë bartëse të rezistencës kombëtare në Kosovë dhe është njëra ndër komunat më të dëmtuara nga lufta e fundit. Komuna e Drenasit shtrihet në pjesën qendrore të Kosovës, ku një sipërfaqe prej 290 km/2 68,526 banorë që jetojnë në 42 vendbanime, 41 fshatra dhe qytezën e Drenasit. Kjo komunë është e njohur për shkritoren “Feronikeli” e cila tani është privatizuar. Përndryshe, pothuajse gjithë ekonomia e kësaj komune është e koncentruar në bujqësi. Në mesin e prodhimeve bujqësore më të kultivuara në këtë komunë janë gruri, misri, luledielli etj. Këtë ia ndihmon edhe prezenca e dy lumenjve të mëdhenj që përshkojnë këtë komunë, lumi Drenica dhe Vërbica.

Problemet aktuale

Problemet e qytetarëve të komunës së Drenasit nuk dallojnë shumë nga problemet e pjesës tjetër të Kosovës. Dikur në komunën e Drenasit, ndërmarrja shoqërore “Feronikeli” ka punësuar rreth 2,000 punonjës, nga Drenasi dhe komunat tjera të Kosovës. Pas privatizimit me spin-off special, kompanisë fituese i ishte kërkuar që të punësoj së paku 1,000 punonjës. Papunësia mbetet një nga shqetësimet kryesore të qytetarëve. Nga 68,526 banorë, 41,801 janë persona të aftë për punë (15-64 vjeç). Papunësia arrin shkallën prej 64%. Kjo shkallë e radhit Drenasin një ndër katër komunat me numrin më të lartë të papunësisë (pas Skenderajt, Klinës dhe Deçanit). 1,828 familje me 9,067 anëtarë janë të varur nga ndihmat sociale (13.2% e popullsisë). Përveç këtyre problemeve, shqetësimet e qytetarëve kanë të bëjnë edhe me:

- Ndotja e ambientit
- Mungesa e aktiviteteve rinore
- Sistemi i ujësjellësit dhe kanalizimit
- Administrata
- Infrastruktura shkollore
- Cilësia e dobët e infrastrukturës rrugore

Ndotja e ambientit. Shkritorja “Feronikeli” e privatizuar në vitin 2007, në fillim shihej nga shumica dërmuese e qytetarëve të Kosovës, e veçanërisht e atyre të komunës së Drenasit, si një nga burimet kryesore gjeneruese ekonomike. Shpresohet që në të do të punësoheshin mijëra vetë, e kjo do t’i nxirrte nga varfëria shumë familje. Mirëpo, ky gjigant metalurgjik ka sjell edhe një problem shqetësues. Tymi që nxjerr kjo fabrikë ka ndikuar në dëm të shëndetit të popullatës që jeton përreth. Vetëm në vitin 2008, gjithsej 4 vdekje kanë ndodhur mu në lagjen Sukat që gjendet shumë afër lokacionit ku gjendet edhe kompania ‘Feronikeli’. Mjekët kanë konstatuar se këto vdekje kanë ardhur drejtpërdrejtë nga tymi që lirohet gjatë prodhimit të materialeve të ndryshme metalurgjike. Për më tepër, në lagjen Sukat ndodhet edhe deponia e mbetjeve që bëhen gjatë prodhimit, deponi e cilat konsiderohet të rrezikshme për shëndetin e banorëve.

Komuna i ka dhënë një ultimatum menaxhmentit të kësaj kompanie që t’i instaloj filtrat të cilat konsiderohen tejet të domosdoshëm për të reduktuar efektin e gazit që

lirohet si pasoj e prodhimit të nikelit. Edhe pse ky ultimatum ka një afat kohor deri më 15 tetor të këtij viti, asnjë aksion nuk është ndërmarrë nga ana e kompanisë. Për më tepër, menaxhmenti i "Ferronikel" thotë se deri më tani kurrfarë vendimi nuk ka arritur në adresën e tyre dhe mohon të ketë marrë ndonjë ultimatum.

Ndotjes së ambientit i kontribuojnë edhe gurëthyesit privat që ndodhen në fshatrat si Baincë dhe Çikatovë të Vjetër, gurëthyes të cilët po shkaktojnë kaos të madh ekologjik nga pluhuri që lirohet nga gërmimet dhe përpunimi i zhavorit. Prandaj, vendosja e filtrave, largimi i deponisë në fshatin Sukat si dhe menaxhimi më i mirë i gurëthyesëve, janë disa nga kërkesat e banorëve të kësaj komune.

Mungesa e aktiviteteve rinore. Sipas statistikave të përlogaritura në nivel kombëtar, 65% e popullatës kosovare është nën moshën 30 vjeçare, vlerësime këto që vlejné edhe për komunën e Drenasit. Pra nga numri i përgjithshëm prej 75,000 banorëve të kësaj komune, 48,750 e tyre janë nën moshën 30 vjeçare. Jeta rinore në komunë është tepër e zymtë ku pjesa dërmuese e të rinjëve kohën e kalojnë në qendrën tregtare të qytetit, aty ku ndodhen edhe kafenetë. Të vetmin aktivitet rinor që organizon komuna është kremtimi i ditës së rinisë që organizohet çdo vit (edhe kjo kremte nga shumica e të rinjve konsiderohet si e paorganizuar mirë dhe me program jo atraktiv).

Si në shumë komuna tjera të Kosovës, edhe komuna e Drenasit ballafaqohet me problemin e **ujësjellësit dhe kanalizimeve**. Edhe pse gjatë këtij mandate dy vjeçar ka pasur disa investime sa i përket ujësjellësit (si në Terstenik II, Gllanasellë dhe Likoshan), banorët e këtyre fshatrave akoma kanë mungesë të ujit të pijshëm. Mungesa e ujit të pijshëm ndihet edhe në fshatrat si Baincë, Abri, Tërdec, Krajkovë, Shtuticë, Polluzhë, Vërbovc, Tërstenik, Gradicë, Vasilevë, Komorran, Llapushnik, Gllanasellë që përfshijnë përafërsisht 25 mijë banorë. Në përgjithësi ndihet një mungesë e madhe e ujit të pijshëm si në zonat rurale ashtu edhe në ato urbane.

Sa i përket sistemit të kanalizimeve, këtë vit organet komunale në bashkëfinancim me USAID-in kanë investuar në disa projekte të kanalizimeve, projekte që ende nuk kanë përfunduar. Sistemi i kanalizimit në fshatin Gllobar, Baicë, Llapushnik, Shtrubullo, Poklek i Ri, kanë përfunduar mirëpo nuk është vënë në funksion ende. Derdhja e të gjitha këtyre ujërave të zeza bëhet në lumin Drenica në të cilin nuk ekziston asnjë gropë septike. Megjithatë, qyteti ka një gropë septike në të cilën nuk është ndërmarrë asgjë rreth pastrimit të saj.

Sipas qytetarëve të intervistuar dhe të cilët gjatë këtyre viteve janë ballafaquar me administratën komunale për nevoja të ndryshme, **rregulli në administratë** është në nivelin më të ulët. Sidomos gjatë kohës së verës, kur edhe mërgimtarët kthehen në Kosovë dhe secili prej tyre ka nevojë për dokumentacion në komunë. Problemet në administratë, sidomos në ofiqari, kanë të bëjnë me mos respektimin e orarit të punës, mos aftësinë e punonjësve për të kryer punën e tyre, gabimet e shumta në dokumentacionet që lëshohen (dhe për çdo gabim qytetarët duhet të paguajnë sërish).

Arsimi në nivel komunal nuk ndodhet në gjendje të mirë. Në fshatin Gllobar ndihet nevoja për një objekt të ri shkollor, pasi që objekti i shkollës aktuale është në gjendje shumë të rëndë. Shkolla e cila ka qenë e ndërtuar afër lagjes së fabrikës "Ferronikeli" është djegur gjatë kohës së luftës dhe nuk është ndërtuar më, kështu që nxënësit e kësaj lagjeje u duhet që të udhëtojnë deri në shkollën e Drenasit, e cila në anën tjetër nuk ka hapësirë të mjaftueshme shkollore dhe zhvillon mësim në tri ndërrime.

Cilësia e dobët e infrastrukturës rrugore. Kuvendi komunal i Drenasit ka implementuar një mori projektesh rrugore ku shumë vendbanime që kanë pasur mungesë të infrastrukturës rrugore tani më këtë çështje e kanë të zgjidhur. Megjithatë, qytetarët ankohen se edhe përkundër nevojës për ndërtimin apo asfaltimin e këtyre rrugëve, cilësia e tyre është tejet e dobët. Shumë rrugë të cilat janë asfaltuar në vitin e kaluar siç janë: rrugët e fshatrave Shtuticë, Gradicë, Arbri, Drenas III, Likoshan etj., në to tani kanë filluar të krijohen gropa dhe qarje.

Premtimet dhe puna e Kryetarit të Komunës

Drenasi është një nga katër komunat e Kosovës që vazhdimisht është qeverisur nga PDK. Në mandatin e parë qeverisës (2000-2002) si kryetar komune ka shërbyes Izet Ibrahim. Pas zgjedhjeve të vitit 2002, kryetar komune u zgjodh Gani Sylaj. Gani Sylaj u detyrua të tërhiqet nga posti i të parit të komunës në 2005, pas protestave të qytetarëve me arsyetimin e menaxhimit të dobët me komunën. Në vend të tij u vendos Sherif Krasniqi. Në zgjedhjet e 17 nëntorit 2007 për postin e kryetarit të komunës PDK konkurroi me Nexhat Demakun. Demaku arriti që të siguroj fitoren që në raundin e parë të votimeve ku fitoi 66.06%.

Gjatë fushatës para zgjedhore të vitit 2007, Nexhat Demaku kishte premtuar një serë projektesh. Tabela 1 pasyqron të gjitha premtimet e dhëna në debatet zgjedhore të 2007 në emisionin “Jeta në Kosovë” dhe realizueshmëria e tyre pas dy vitesh.

Tab.1. Premtimet dhe realizueshmëria e tyre

Premtimet	Realizimi
Ndërtimi i sheshit “Skënderbeu”, në vlerë të përgjithshme prej 300.000 euro;	Projekti është në fazën e dytë të ndërtimit, por me shumë ngecje. Tani më kanë kaluar një vit e gjysmë që nga fillimi i punimeve dhe punimet ende nuk kanë përfunduar.
Ndërtimi i rrugës në Shtuticë, në vlerë prej 100.000 eurosh.	Rruga është asfaltuar. Mirëpo, qytetarët shprehen se kjo rrugë është shtruar shumë dobët dhe kanë filluar plasaritjet e asfaltit.
Ujësjellësi në Terstenik II që kap shumën prej 88.675 eurosh	Projekti është realizuar dhe janë shpenzuar 73.675 euro. Mirëpo, edhe pse kjo lagje tani ka ujësjellës, ende mbetet problem furnizimi me ujë të mjaftueshëm.
“Feronikelit” të vendos gypat filtrues.	“Feronikelit” nuk ka vendos filtrat. Sipas zyrtarëve të Feronikelit, filtrat nuk do të mund të vendosen deri kah mesi i vitit 2010.
Grumbullimi i një ekip ekspertësh dhe në bashkëpunim me ta do të gjenden rrugë për rritjen e buxhetit dhe rritja e investimeve në këtë komunë	Nuk ka ndonjë shenjë që kryetari i komunës ka grumbulluar ndonjë ekip ekspertësh për këtë qëllim. Megjithatë, buxheti i komunës së Drenasit është rritur në krahasim me vitin e kaluar. Mirëpo vien të theksohet se buxheti i 2009 është rritur në të gjitha komunat e Kosovës. Nuk ka pasur rritje të investimeve në këtë komunë.

Zgjedhjet lokale në Drenas

Në Kuvendin Komunal të Drenasit mund të zënë ulëse 31 përfaqësues. Në tri mandatet e gjertanishme përfaqësuesit e tetë partive kanë arrit që të zënë ulëse në KK. Vetëm PDK dhe LDK kanë arrit që të zënë ulëse vazhdimisht në të tre mandatet e KK. PDK gjithnjë ka mbajtur numrin më të madh të ulëseve në KK, edhe pse me një rënie të lehtë pas çdo zgjedhje, si në numrin e votave ashtu edhe në numrin e ulëseve. Në mandatin e parë kanë qenë të përfaqësuara vetëm dy parti (PDK dhe LDK); në mandatin e dytë tri parti (plus Balli Kombëtar); kurse, legjislatura e tretë (2007-2009) shënon njëkohësisht edhe numrin më të madh të partive që kanë arrit të përfaqësohen në KK të Drenasit.

Përderisa në shumicën e komunave ku KK-të kanë pasur 31 anëtar, që nga mandati i ardhshëm do të kenë 27, Drenasi edhe më tutje do të ketë 31 ulëse.

Tab.2. Partitë të cilat kanë arritur që të fitojnë ulëse në KK të Drenasit.

Partia	Zgjedhjet 2000		Zgjedhjet 2002		Zgjedhjet 2007	
	Nr. i Votave	Ulëse në KK	Nr. i Votave	Ulëse në KK	Nr. i Votave	Ulëse në KK
PDK	18587	27	17313	26	13402	22
LDK	2856	4	2418	4	742	1
AAK	-	-	-	-	1323	2
LDD	-	-	-	-	444	1
AKR	-	-	-	-	569	1
IBQ	-	-	-	-	1805	3
ORA	-	-	-	-	415	1
Balli Kombëtar	-	-	578	1	-	-

Edhe numri i votuesve ka shkuar duke rënë gjithnjë në tri palë zgjedhjet lokale. Përderisa në zgjedhjet e para lokale dalja e votuesve në zgjedhje ishte 85%, në zgjedhjet e vitit 2002 dalja në votime ta në 62.9%. Ndërkaq, në zgjedhjet e vitit 2007, pjesëmarrja në votime kishte rënë edhe më shumë në 52.2%. Në zgjedhjet e nëntorit 2009, të drejtë vote do të kenë 44,718 qytetarë.

Tab.3. Statistikat e daljes së votuesve në zgjedhjet lokale në Drenas në tri palë zgjedhjet e gjertanishme

	2000	2002	2007	2009
Votues me të drejtë vote	21997	33941	36065	44718
Pjesëmarrja në votime	22840	21348	18844	-
Përqindja e daljes në votime	85%	62.90%	52.2%	-

Buxheti i Komunës

Buxheti i Komunës së Drenasit kryesisht ka shkuar duke u rritur prej vitit në vit, me përjashtim të vitit 2005. Deri në vitit 2008 kjo komunë kishte një buxhet mesatarisht prej 4 milion euro. Buxheti i vitit 2009 është buxheti më i lartë që ka pasur kjo

komunë, gjithsej 6,500,280 euro, që do të thotë se këtë vit Drenasi ka një buxhet dyfish më të madh krahasuar me vitin 2003. Nga buxheti i vitit 2009, vetëm 1,6 milion euro janë shpenzuar për investime kapitale, përderisa pjesa më e madhe e buxhetit është shpenzuar për rroga dhe mëditje.

Tab.4. Shpenzimet buxhetore sipas viteve dhe sipas linjave buxhetore

Viti	Rrogat dhe mëditjet	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencionet dhe transferet	Shpenzimet kapitale	Gjithsej
2009	€3,928,774	€752,131	€145,051	€72,709	€1,601,615	€6,500,280
2008	€3,276,120	€821,967	€133,302	€72,709	€680,640	€4,984,738
2007	€3,117,489	€579,557	€167,302	€100,400	€657,203	€4,621,951
2006	€3,099,618	€451,706	€101,732	€46,570	€859,399	€4,559,025
2005	€3,012,609	€418,405	€85,900	€11,400	€943,406	€4,471,720
2004	€2,958,096	€876,445	-	-	€836,038	€4,738,305
2003	€2,286,341	€820,305	-	-	€744,067	€3,893,012

Investimet kapitale

Nga buxheti i vitit 2009, Komuna e Drenasit për investime kapitale ka ndarë 1,601,515 euro. Ndërkaq, nëse i shtohet kësaj edhe buxheti i ndarë për investime kapitale i vitit 2008, del se kjo komunë ka pas në dispozicion mbi 2.2 milion euro për investime kapitale. Ndër projektet e financuar nga ky buxhet janë:

Tab.5.: Investimet kapitale në Drenas gjatë 2008 dhe 2009

Viti	Emri i projektit	Shuma e Projekteve
2008	Ndërtimi i aneksit në fshatin Zenel Hajdini Tërstenik	€76,000
2008	Ndërtimi i rrugës për guri të plakës	€109,038
2008	Ndërtimi i sheshit "Skenderbeu"	€150,000
2008	Asfaltimi i rrugës në fshatin Shtuticë	€103,828
2008	Asfaltimi i rrugës në fshatin Vuqak	€240,000
2009	Ndërtimi i palestrës sportive	€85,318
2009	Ndërtimi i ujësjellësit në fshatin Polluzh	€50,000
2009	Ndërtimi i infrastrukturë në lagjen e Dëshmorëve	€51,615
2009	Asfaltimi i rrugës në Tërdec (faza e II-të)	€60,000

Kuvendi Komunal i Drenasit ka miratuar edhe Buxhetin e Komunës për vitet 2010-2012. Sipas vlerësimeve, në tri vitet në vazhdim, komuna e Drenasit do të ketë në dispozicion 6,601,117€ për investime kapitale.

Tab.6.: Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Drenasit 2010-2012

Buxheti	2010	2011	2012
Buxheti i përgjithshëm në €	7,412,727	7,559,632	7,824,289
Të hyrat vetanake në €	627,741	647,669	666,352

Investimet kapitale në €	2,234,780	2,127,028	2,239,309
--------------------------	-----------	-----------	-----------

Nëse mund të japim një vlerësim të përafërt edhe për vitin 2013, duke u bazuar në vlerësimet buxhetore 2010-2012, atëherë mund të përfundojmë se kryetari i ardhshëm i komunës së Drenasit për mandatin e tij qeverisës katërvjeçar do të ketë në dispozicion pak më shumë se 9 milion € për investime kapitale.

Administrata komunale

Komuna e Drenasit ka 1,291 punonjës të punësuar në arsim, shëndetësi dhe administratë. Krahasuar me vitin 2008, numri i këtij stafi është ngritur për pesë persona. Ndërkaq vetëm në administratën komunale janë të punësuar 121 punonjës. Sipas vendimit 10/46 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, komuna e Drenasit nuk duhet të ketë më shumë se 152 punonjës në administratën e saj lokale (1 shërbyes civil për 620 banorë). Nga kjo mund të nënkuptojmë se administrata komunale ka të drejtë të rrisë numrin e stafit të saj.

Tab.7. Numri i punonjësve në sektorin publik në Komunën e Drenasit sipas viteve

Viti	Nr total i të punësuarve në arsim, shëndetësi dhe administratë
2009	1291 ▲
2008	1286 ▲
2007	1273
2006	1304 ▲
2005	1291
2004	1297 ▲
2003	1222 ■

Komuna e Drenasit dhe Ligji për Vetëqeverisje Lokale

Sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale, Kuvendi Komunal duhet të mbajë të paktën 10 mbledhje. KK i Drenasit ka mbajtur gjithsej 10 mbledhje, aq sa edhe kërkohet me ligj. Kurse gjatë periudhës janar-qershor 2009, KK i kësaj komune ka mbajtur 5 mbledhje, duke përmbushur kështu normën e paraparë me nenin 43.2 të ligjit të lartpërmendur. Edhe Komiteti për politikë dhe financa ka funksionuar normalisht, ku gjatë vitit 2008 është takuar gjithsej 8 herë, kurse në gjashtëmujorin e parë të vitit 2009 ka mbajtur gjithsej 5 mbledhje. Komiteti për politikë dhe financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik të komunës.

Sa i përket bashkëpunimit me qytetarët, komuna e Drenasit ka mbajtur 2 tubime publike brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 2009, përderisa mungojnë të dhënat nëse kjo komunë ka mbajtur ndonjë tubim me qytetarë gjatë vitit 2008. Sa i përket

kërkesave për qasje në dokumentet zyrtare, nuk ka ndonjë të dhënë nëse komuna e ka pranuar një gjë të tillë. Ndërsa sa i përket peticioneve, kjo komunë ende nuk ka marrë ndonjë peticion nga ata e qytetarëve.

Drenasi ka edhe uebfaqen zyrtare. Ueb faqes së komunës së Drenasit i mungojnë një sërë informacionesh ashtu që një qytetari do t'i nevojiteshin rreth aktiviteteve të komunës siç janë, p.sh.: shërbimet komunale nuk janë të paraqitura fare, informacione rreth qytetit janë krejtësisht të cekëta, si dhe në pikëpamje të strukturës ueb faqja ka mangësi të mëdha.

Tab.8. Niveli i përmbajtjes së informacioneve në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Drenasit (www.drenasi-komuna.org)

Kategoritë e informacioneve	Niveli i informatave ²
Ballina	4
Organizimi komunal	2.33
Shërbimet komunale	1
Info rreth qytetit	1.88
Projektet komunale	2.75
Lajme& lajmërimet	2
Harta e faqes	1
Kontakt	5
Gjuhët	2
Fusha për kërkim	1
Tjera informacione shtesë	2
Baza Ligjore	4
Mesatarja totale	2.41
Renditja në krahasim me ueb faqet e komunave tjera	21

Gjendja në arsim

Arsimi në komunën e Drenasit zhvillohet në tri nivele; parashkollor, fillor dhe të mesëm. Në këtë komunë funksionojnë 3 çerdhe fëmijësh me gjithsej 989 fëmijë. Sa i përket shkollave fillore, ekzistojnë 32 shkolla fillore, përfshirë këtu edhe paralelet e ndara. Në këto shkolla vijnë mësimin 11,144 nxënës të gjithë të komunitetit shqiptar. Në 3 shkolla të mesme me mësimet i ndjekin 3,522 nxënës. Kjo komunë ka 791 mësimdhënës, apo 1.4 punonjës të arsimit për 100 banorë, statistikë kjo që është e kënaqshme krahasuar me komunat tjera që kanë mesatarisht 1.3 punonjës për 100 banorë.

Gjendja në shëndetësi

Komuna e Drenasit ka Qendrën Komunale të Mjekësisë Familjare 'Dr.Hafir Shala', shtëpinë e shëndetit në Komoran, Qendrën e përkujdesit për shëndetin mental në Drenas dhe 7 punkte shëndetësore nëpër fshatra. Shtëpia e shëndetit ofron 11

² Radhitja nga 1 deri 5: 5 - shkëlqyeshëm, 4-shumë mirë, 3-mirë, 2-mjaftueshëm, dhe 1-dobët.

shërbime të specializuara. Po ashtu ekzistojnë edhe shtatë ordinaanca private të mjekëve dhe nëntë barnatore. Komuna e Drenasit ka 38 mjekë, kurse numri i përgjithshëm i punëtorëve shëndetësor në këtë komunë është 182 punonjës. Sipas përpjesëtimit 1 punëtor shëndetësor për 1,000 banorë, kjo komunë ka një mesatare prej 2.7 punëtorë, që nuk është edhe keq krahasuar me komunat tjera të Kosovës.

Shoqëria civile

Në komunën e Drenasit, ekzistojnë 21 organizata jo qeveritare të regjistruara, por shumica prej tyre nuk janë aktive, apo merren me shumë pak aktivitete. Ndër organizatat joqeveritare më aktive janë “Aureola” e cila merret me sensibilizimin e qytetarëve, kryesisht për problemet e grave; organizata “Zana” e cila merret me përkujdesjen e fëmijëve; “Gratë kundër dhunës”, organizatë e gruas e cila ka për qëllim ngritjen e vetëdijesimit të qytetarëve kundër dhunës në familje; “Edukata” e përkrahur prej MASHT-i dhe Kuvendit Komunal të Drenasit, e cila posedon një bibliotekë të pasur me libra; “Ekodi” organizatë kjo që merret me mbrojtjen e ambientit që është shumë aktive. Komuna e Drenasit ka edhe një sërë organizata joqeveritare të cilat zhvillojnë aktivitete, edhe pse jo të shumta, siç janë “Këshilli i Veprimit Rinor”, “Rrjeti Rinor” Optimizmi”, “Sibora”, “Qendra Rinore”, etj. Buxheti komunal për përkrahjen e organizatave joqeveritare është 8,000-10,000 euro në vit, të cilat, sipas komunarëve, ndahen varësisht nga vlefshmëria e projektit. Megjithatë, komunës së Drenasit i mungon një organizatë joqeveritare e cila do të merrej me monitorimin e kuvendit komunal. Qendra Rinore, e cila dikur ishte vendi ku OJQ-të vepronin tani i është dhënë Caritas-it, dhe OJQ-të nuk kanë më vendin e tyre; edhe pse ka shume premtime nga institucionet se në vitet në vijim do të ndërtohet një qendër e re rinore, kjo nuk është paraparë në planifikimin e projekteve për vitet 2010-2012.

Mediat lokale

Në Komunën e Drenasit funksionojnë 2 radio lokale: Radio Drenasi dhe Radio Dodona. Radio Drenasi në të kaluarën ka transmetuar mbledhjet e KK. Radio Dodona është radio më aktive sa i përket përcjellës së aktiviteteve dhe problemeve komunale dhe bënë transmetimin e mbledhjeve të asamblesë komunale. Zyrtarët komunal kanë premtuar se do të bëjnë marrëveshje me njërin prej Radiove lokale, sidoqoftë një premtim i tillë nuk është përmbushur. Komuna nuk ka gazetë lokale, por ka korrespondent të gazetave të përditshme si “Zëri”, “Infopress”, “Koha Ditore”, etj. Gazetarët në bashkëpunim me disa organizata joqeveritare dhe grupe rinore synojnë të organizojnë një petition kundër ndotjes së ambientit të cilin e shkakton “Ferronikeli”, dhe me të cilin kërkohet vendosja e filtrave apo mbyllja e fabrikës.

Rendi dhe ligji në Komunën e Drenasit

Nga 1 janari 2008 deri 31 dhjetor 2008, në Komunën e Drenasit kanë ndodhur 1291 raste të shkeljes së rendit dhe ligjit, në gjithsejtë 57 shkelje të natyrave të ndryshme. Shkeljet më të mëdha kanë ndodhur në këto fusha:

Tab.9. Numri i rasteve më të shpeshta të shkeljes së rendit dhe ligjit në Drenas (2008)

Natyra e shkeljes së rendit dhe ligjit	Numri i rasteve të shënuara
Aksidente	404
Prishja e rendit dhe qetësisë publike	148
Pengim i personave zyrtar në kryerjen e punës	30
Vjedhje e pyjeve	1
Incidente lidhur me pronën	79
Vjedhje	260
Abuzime seksuale	5
Shkaktim të dëmtimeve trupore	64
Kërcënime	45
Mashtrome	10
Vrasje	5
Incidente në baza etnike, religjioze apo racore	0

Komuna e Drenasit hyn në mesin e pesë komunave që kanë pasur më së shumti aksidente trafiku. Vetëm gjatë vitit 2008 janë shënuar gjithsej 404 aksidente. Edhe rastet e prishjes së rendit kanë shënuar rritje, ku 148 raste janë shënuar vetëm në vitin 2008. Vjedhjet ende mbesin problem serioz për këtë komunë, ku gjatë një viti janë shënuar 260 raste të tilla.

Tatimi në pronë

Bazat për vënien e tatimit në pronë në Kosovë ende përllongariten sipas Rregullores së UNMIK-ut 2003/29 për tatimin mbi pronën e paluajtshme në Kosovë. Sipas kësaj rregulloreje, Kuvendi Komunal i çdo komune i cakton tarifat tatimore mbi pronën në bazë vjetore në shkallën prej 0.05% dhe 1% të vlerës së pronës në treg. Tarifat e tatimit lëvizin brenda kategorive vijuese të pronës: pronë për banim, pronë komerciale, pronë industriale dhe pronë bujqësore.

Tab.10. Tatimi në pronë në Komunën e Drenas

Zona	Pronë për banim		Prona komerciale	Prona Industriale	Prona bujqësore
	Banesa	Shtëpi			
	Norma tatimore				
	0.13%	0.13%	0.20%	0.30%	0.05%
I	350€*	300€	600€	150€	100€
II	320€	250€	450€	150€	100€
III	-	200€	350€	150€	100€
IV	-	150€	270€	150€	100€

* Vlera e tregut për metër katror.

Kostoja për biznese

Në Komunën e Drenasit janë të regjistruara rreth 1,216 biznese. Bizneset janë të regjistruara në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, kurse leja e punës u lëshohet nga administrata komunale. Duke u bazuar në Rregullore komunale për taksa, gjoba dhe ngarkesa, më poshtë kemi pasqyruar disa nga bizneset më të zakonshme dhe shumat e mjeteve që ato duhet të paguajnë për leje të punës.

Tab.11. Llojet e bizneseve dhe taksa vjetore që janë të detyruara të paguajnë për leje të punës

Lloji i biznesit	Taksa vjetore e punës
Veprimtaria e minierave	7,500 €
Gurrëthyesit	3,500 €
Bankat	300 €
Kompanitë e sigurimit	300 €
PTK komunikimi dhe distribucioni	300 €
Agjensionet turistike	200 €
Hotelet	200 €
Motelet	200 €
Supermarketet-Hipermarketet	200 €
Vetëshërbimet - Minimarketet	100 €
Shitoret	100 €
Kafeteritë	100 €
Restorant	100 – 200 €
Libraritë	60 €
Kioskat	50 €
Barnatoret (Farmacitë)	200 €
Autoshkollat	60 €
Çajtoret	40 €
Punëtoritë (argjendaritë, zdrukthëtaritë, automekanikët, bukëpjekësit, floktarët, etj.)	60 – 100 €
Ndërmarrjet (ndërtimore, industriale, etj.)	200 €
Pompat e benzinës	300 €
Veprimtaritë e pavarura profesionale (mjekët, stomatologët, avokaturat, arkitektët, etj.)	150 €

Burimet:

1. Intervista të drejtpërdrejta me qytetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile dhe media lokale. Shtator-tetor, 2009.
2. Ministria e Ekonomisë dhe Financave. Raportet Vjetore Financiare të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitet 2003-2009. (<http://mef-rks.org/sq/download/314-raportet-e-buxhetit-dhe-pasqyrat-financiare>);
3. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2010-2012 - raporte të miratuara nga të gjitha Kuvendet Komunale deri më 30 shtator 2009.
4. Rregulloret Komunale për tatim në pronë - të miratuara nga Kuvendet Komunale.
5. Rregulloret për taksa, gjoba dhe ngarkesa - të miratuara nga Kuvendet Komunale.
6. Debatet komunale 2007 "Jeta në Kosovë", www.jetanekosove.com.
7. ESK. Analiza e Statistikave Vitale të Kosovës për periudhën më të re. Prishtinë, shkurt 2008.
8. UNDP. Human Development Report - Kosovo 2004.
9. Asociacioni i Komunave të Kosovës. Komunat e Kosovës-profil i shkurtër. Qershor, 2008.
10. MAPL. Raport i funksionimit të Komunave të Kosovës - janar-dhjetor 2008. Janar, 2009.
11. MAPL. Raport i funksionimit të Komunave të Kosovës - janar-qershor 2009. Shtator, 2009.
12. MASHT. Statistikat e Arsimit në Kosovë. Prishtinë, 2009.
13. Policia e Kosovës. Statistika ne lidhje me raste të ndryshme kriminale dhe aksidente të komunikacionit. 24 gusht 2009.
14. Komisioni Qendror Zgjedhor. Zgjedhjet komunale 2000, 2002 dhe 2007. Si dhe listat e votuesve me të drejtë vote për zgjedhjet e 2009.
15. MPMS-Departamenti i Mirëqenies Sociale. Shfrytëzuesit e Ndhmës Sociale Sipas Komunave. Qershor, 2009.
16. Ministria e Shërbimeve Publike. Të dhënat e të punësuarve në administratë në komuna. Mars, 2008.